



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 27.06.2023

RAPORT PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN 2022 DHE MIRATIMIN E PROJEKTREZOLUTËS PËR VLERËSIMIN VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN 2023

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 20 Maj 2023, në zbatim të nenit 104, të ligjit nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 18, dhe 103 të Rregullores së Kuvendit, mori në shqyrtim “Raportin mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme për vitin 2022”.

Raporti vjetor, pasqyron të dhëna, për volumin e punës në hetim, volumin e punës në gjykim, ekzekutimin e vendimeve penale, konfiskimin e pasurisë në proces penal, përgjimet e komunikimeve elektronike etj.

Përmbledhja e Raportit të Prokurorisë së Posaçme për vitin 2022, u prezantua nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Altin Dumani.

Pas përfundimit të prezantimit të raportit vjetor, relatori e çështjes, i caktuar nga komisioni, z. Pandeli Majko parashtrori mendimin e tij mbi raportin, dhe vlerësoi veprimtarinë e SPAK-ut gjatë vitit 2022.

Z. Majko i drejtoi disa pyetje drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme lidhur me aspekte të veprimtarisë së tij.

Pas prezantimit të raportit vjetor, diskutimeve dhe pyetjeve të deputetëve, u konstatuan disa arritje dhe problematika të këtij institucioni, për të cilat u sugjerua që të reflektohen në projekt-rezolutën që do miratohej nga Komisioni për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) për vitin 2022.

Në mbledhjen e datës 27 Qershor 2022, në Komision u diskutua dhe për projekt-rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) për vitin 2022”. Komisioni me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi projekt-rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022”, sipas propozimit të relatorit, duke pasqyruar në versionin final

edhe sugjerimet konsultuar me institucionin me qëllim paraqitjen për votim seancës plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Bashkëlidhur teksti integral i Projekt-Rezolutës.

RELATOR

Pandeli MAJKO

KRYETARE

Klotilda BUSHKA